



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

RAPORTI PËR VEPRIMTARINË VJETORE 2022

31 Mars 2023

Raportim në Kuvendin e Shqipërisë

Veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2022 në mënyrë të përmbledhur përfshin:

- 1) Administrimin e materialit zgjedhor të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021;
- 2) Përgatitjen dhe zhvillim e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të bashkive Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022;
- 3) Këqyrjen dhe administrimin paszgjedhor të dokumentacionit dhe materialit të zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 Mars 2022;
- 4) Administrimin dhe vlerësimin e raporteve financiare vjetore të partive politike;
- 5) Zhvillimin e programeve të edukimit të zgjedhësve;
- 6) Përmirësimin e organizimit dhe të funksionimit të strukturës organike të KQZ, si dhe të performancës së kësaj strukture;
- 7) Përgatitjen për zgjedhjet vendore të vitit 2023;
- 8) Të ndryshme.

Në zhvillimin e kësaj veprimtare KQZ ka patur në vëmendje Rezolutat e mëparshme të Kuvendit të Shqipërisë.

Nga ana tjetër veprimtari konkrete zgjedhore janë zhvilluar edhe si përmbushje të rekomandimeve të OSBE/ODIHR, por edhe të organizatave të tjera vëzhguese ndërkombëtare dhe vendase.

1)

Administrimin e materialit zgjedhor të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Me vendimin nr.3, datë 22.01.2022, u vendos hapja e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Ky proces përfaqëson një volum të madh pune për KQZ.

Janë numërtuar në total 320 077 fletë dokumentacioni zgjedhor

Materiali zgjedhor i gjendur në këto kuti, pasi u evidentua dhe u organizuar sipas rregullave të arkivimit u dorëzua pranë Arkivit Qendror të Shtetit.

KQZ mban një kopje të dokumentacionit zgjedhor, si listat shumëmemërore të partive politike, tabelat e rezultateve, tabelat që janë plotësuar sipas kërkesave ankimore dhe tabelat e këqyrjes nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhje, vendimet e emërimit/lirimit të anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe vendimet e grupit të numërimit të votave. Kopja e dokumentacionit zgjedhor është skanuar për t'u bërë pjesë e arkivës elektronike të KQZ.

2)

Përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të bashkive Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 Mars 2022.

Procesi i i përgatitjes së zgjedhjeve të pjesëshme të datës 6 Mars 2022 u parapri nga miratimi i akteve nënligjore nga Komisioni Rregullator dhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**Komisioni Rregullator ka miratuar 26 (njëzet e gjashtë) vendime.**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka miratuar 80 akte nënligjore, nga të cilat 76 janë vendime, 2 udhëzime dhe 2 urdhra.**

Në respektim të plotë të parimit të transparencës, procesi i hartimit të projektakteve nënligjore iu nënshtrua **konsultimit me të gjitha partitë politike dhe/ose me grupe të tjera interesi.**

Procesi i miratimit të akteve nënligjore u zhvillua në seanca publike.

**Në zgjedhjet e pjesëshme për kryetar bashkie në Bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, u regjistruan gjithsej 9 (nëntë) parti dhe 1 (një) koalicion.**

Për këto zgjedhje u regjistruan 20 kandidatë për kryetar bashkie nga të cilët 3 (tre) gra dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) burra.

Nga verifikimi i 20 kandidatëve rezultoi se:

- 1 (një) kandidat kishte deklaruar dënim;
- 19 (nëntëmbëdhjetë) kandidatë nuk kishin deklaruar dënim;
- 8 (tetë) kandidatë kanë rezultuar me ndryshime në gjenealitete;

**Procesi i konstituimit të KZAZ-ve në zgjedhjet e datës 6 mars 2022 u krye në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet e KQZ.**

**Lidhur me konstituimin e Komisioneve të Qendrave të Votimit, u emëruan rreth 6200 komisionerë të qendrave të votimit nga 6594 në total. Gjithësesi në të gjitha QV ka pasur kuorum për vendimmarrje dhe rrjedhimisht procesi i votimit nuk u bllokua.**

Me problematika u shoqërua procesi i konstituimit të KQV-ve në KZAZ 26, bashkia Vorë. Polemikë dhe debatet ndërmjet anëtarëve të kësaj KZAZ mbi përputhshmërinë me nenin 38 të Kodit Zgjedhor të propozimeve të Partisë Demokratike për anëtarë të KQV sollën një situatë bllokuese të procesit në këtë KZAZ

**Me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 130, datë 5 mars 2022, u miratua lista me 110 aplikantë nga shoqëria civile për plotësimin e vakancës së krijuar në QV.**

KZAZ nuk e konsideroi listën e të propozuarve nga shoqëria civile.

Subjekti zgjedhor Partia Demokratike kundërshtoi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve vendimarrjen e KZAZ nr. 26 për mosregjistrimin e anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit.

KAS la në fuqi vendimarrjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe urdhëroi KZAZ-në të emërojë anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve, për plotësimin e kuorumit nga lista e miratuar nga Komisioneri.

Mos-emërimi i anëtarëve të KQV jo në kohën e duhur ndikoi negativisht në procesin e trajnimit të tyre dhe të kryerjes së detyrave në funksionimin dhe administrimin e procesit zgjedhor nga KQV.

Tej problematikave të caktimit të antarëve të KQV, **KQZ mori të gjitha masat për zhvillimin e programeve të trajnimit të tyre.**

E njëjta problematikë u reflektua edhe tek procesi i emërimit të anëtarëve të Grupeve të Numërimit, të cilët nuk janë emëruar të gjithë në afatin e duhur ligjor.

**Në tre qendra të votimit të bashkisë Shkodër (QV nr.0092, 0132, 0133) në njësitë administrative Shosh, Shalë dhe Pult, procesi i votimit nuk u zhvillua**

për shkak të kushteve të motit, megjithë angazhimin e KQZ dhe të strukturave të tjera publike.

Tej problematikës në Vorë në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQV-së nga një subjekt zgjedhor dhe moszhvillimit të votimit në tre qendra votimi në Shkodër, procesi i votimit në të 6 bashkitë shkoi shumë mirë.

**Edhe procesi i numërimit dhe tabulimit të rezultateve u zhvillua i qetë, i shpejtë dhe pa tensione.** Ky fakt është evidentuar edhe gjatë procesit të verifikimit paszgjedhor, ku u konstatuan zero devijime nga anëtarët e grupeve të numërimit të votave. Prosesi i numërimit ka përfunduar brenda afateve ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

Në zbatim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, **institucionet publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore raportuan në ndërfaqen e KQZ-së të gjitha veprimtaritë e planifikuara për të zhvilluar në periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.**

Në zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022, KQZ administroi **21 (njëzet e një) denoncime.**

**Për këto zgjedhje u shqyrtuan 9 (nëntë) kërkesa ankimore** nga palë të treta.

8 raste kërkesa ankimore kanë pasur për objekt kundërshtim të vendimmarrjes të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

1 rast kërkesa ankimore ka pasur për objekt kundërshtim i vendimmarrjes së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor.

Për këto zgjedhje është regjistruar 1(një) kërkesë padi në Kolegjin Zgjedhor, në përfundim të së cilës Kolegji Zgjedhor ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Nuk pati asnjë ankim në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve.**

**KQZ zhvilloi një programi të Edukimit dhe informimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit.**

TV lokale, në ato 6 bashki ku kishte zgjedhje, mediat online dhe rrjetet sociale të KQZ, materiale të tjera promociionale, etj ishin mjete të realizimit të këtij programi.

Të gjitha materialet informuese që u përdorën për edukimin, dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet e 6 marsit 2022, në 6 bashkitë e vendit u përkthyen në 4 gjuhët e pakicave kombëtare, ku ata janë të përqendruar zonat ku u zhvillua ky proces zgjedhor, si dhe në gjuhën e shenjave për personat me aftësi të Kufizuar

**KQZ zhvilloi një proces të monitorimit për këto zgjedhje**

U përzgjedhën 20 (njëzet) monitorues.

U administruan **60 (gjashtëdhjetë) raporte monitorimi** si dhe 7 (shtatë) raporte shkeljesh për të cilat është marrë vendim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në këto zgjedhje u implementua identifikimi elektronik në të gjitha qendrat e votimit të të 6 bashkive.

**Identifikimi Elektronik u krye në 99% te qendrave te votimit**, e për pjesën e mbetur prej 1% të QV-ve me proces manual identifikimi kryesisht për shkak të pamundësisë se operatoreve teknike të PEI për t'u paraqitur në QV-të e caktuara për shkaqe të motit në zonat e thella malore apo tërheqjes së operatorëve ditën e zgjedhjeve.

**Në bashkinë Vorë u votua nëpërmjet sistemit elektronik.** Si procesi i votimit, po ashtu edhe procesi i verifikimit paszgjedhor konfirmuan suksesin e përdorimit të këtij sistemi dhe mungesën e problematikave të ndryshme.

Në të gjitha qendrat e votimit edhe në këto zgjedhje u vendosën kamerat e vëzhgimit.

Për zhvillimin e këtyre zgjedhjeve Këshilli i Ministrave i **akordoi KQZ një fond prej 190,000,000 Lekë.**

**3) Këqyrjen dhe administrimin paszgjedhor të dokumentacionit dhe materialit të zgjedhjeve të pjesëshme të datës 6 Mars 2022.**

Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesëshme të 6 Mars 2022, KQZ hapi kutitë e votimit dhe ato të materialeve zgjedhore të këtyre zgjedhjeve.

U evidentua dokumentacioni i gjendur në këto kuti dhe u seleksionua ai sipas rregullave përkatëse të arkivimit. Janë 50.151 fletë dokumentare të numërtuara dhe të administruara.



Nga këqyrja paszgjedhore, në të gjitha QV-të e këqyrura rezultoi se nuk kishte diferencë ndërmjet numrit të votave të pasqyruara në tabelat e rezultateve me numrin e votve të verifikuara gjatë këqyrjes.

#### **4) Administrimin dhe vlerësimin e raporteve financiare vjetore të partive politike;**

Në zbatim të nenit 23, pika 1, të ligjit “Për partitë politike”, ato kanë detyrimin të dorëzojnë raportet financiare 1 (një) herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky raport duhet të dorëzohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në fillim të vitit kalendarik i dërgoi një shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën është kërkuar sa është numri i partive politike të regjistruara në Gjykatë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, informon se janë 132 partitë politike të regjistruara.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i dërgoi një njoftim të gjitha partive politike për detyrimin që kanë për të dorëzuar raportet financiare vjetore në KQZ.

**Nga 132 parti politike të cilave ju dërgua njoftimi, 37 parti politike e morën njoftimin** ndërkohë që për 95 parti politike njoftimi nuk u bë i mundur për shkak të adresës së pasaktë.

Partitë politike të cilat **dorëzuan raportet vjetore financiare për vitin kalendarik 2021, brenda datës 31 mars 2022, janë 46.**

Janë **86 parti politike të cilat nuk kanë dorëzuar raport vjetor financiar** për vitin 2021.

KQZ bëri auditimin e Raporteve financiare Vjetore të dorëzuar nga partitë politike

Me vendimin nr. 224, datë 7.12.2022, u miratua raporti i gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021.

Në vlerësim të këtyre gjetjeve ju propozua KAS-t marrja e masave administrative për 17 parti politike.

Gjithashtu u morën masa administrative dhe për 61 (gjashtëdhjetë e një) Ofrues të Shërbimit Mediatik Audioviziv, si dhe detyrimi për 3 (tre) parti politike të kthejnë në KQZ diferencën sipas nenit 88, pika 7, e Kodit Zgjedhor.

KQZ shqyrtoi edhe raportet e partive për zgjedhjet e pjesëshme të 6 Mars 2022.

Partitë politike të cilat përfituan fonde si ndihmë financiare për vitin 2022, janë si më poshtë vijon:

| <i>Nr</i> | <i>Emërtimi i partisë politike</i>  | <i>Fondi që përfitohet (lekë)</i> |
|-----------|-------------------------------------|-----------------------------------|
| 1         | Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) | 151.494.783                       |

|        |  |             |
|--------|--|-------------|
| 2      | Partia Demokratike (PD)                          | 104.926.170 |
| 3      | Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)  | 9.753.657   |
| 4      | Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) | 8.018.647   |
| 5      | Partia Republikane Shqiptare (PR)                | 13.223.679  |
| 6      | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë (PAA)   | 8.018.647   |
| 7      | Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK)      | 8.018.647   |
| 8      | Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL)               | 8.018.647   |
| 9      | Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)     | 15.577.215  |
| 10     | Partia Social Demokrate (PSD)                    | 12.266.269  |
| 11     | Partia Nisma Thurje (NTH)                        | 6.283.636   |
| TOTALI |  | 345.600.000 |

## 5) Zhvillimin e programeve të edukimit të zgjedhësve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë ka përgatitur dhe ka zhvilluar një Program të Edukimit dhe të informimit të qytetarëve të kategorive të ndryshëm. Ky Program ka synuar më së pari dhe më së shumti rritjen e pjesëmarrjes në

zgjedhje të të rinjve, kryesisht votues për herë të parë, të grave si dhe grupeve vulnerabël.

Në mënyrë të vecantë në kuadër të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit dhe në zbatim të këtij programi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka zhvilluar takime me të gjithë përfaqësuesit e pakicave kombëtare në vend.

Në këto takime është diskutuar për rritjen e bashkëpunimit mes minoriteteve dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve **përgatiti informacionin zgjedhor në 8 gjuhët e 9 pakicave kombëtare** në Republikën e Shqipërisë.

U miratua një program edukimi i posaçëm për Personat me Aftësi të Kufizuar. Ky program u konsultua paraprakisht me organizatat e shoqërisë civile, që mbrojnë interesat e kësaj kategorie. Programi është i detajuar, në mënyrë të tillë që edhe këta zgjedhës të kenë akses në marrjen e informacionit zgjedhor.

Në përmbushje të rezolutës së Kuvendit, dhe adresimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR, të Avokatit të Popullit, në bashkëpunim dhe në konsulencë me shoqatat e personave me aftësi të kufizuar dhe organizata të tjera që operojnë në fushën e zgjedhjeve, hartoi amendimin e udhëzimit përkatës për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, duke përcaktuar kriteret minimale që duhet të përmbushin godinat/ambjenti ku ndodhen qendrat e votimit për të mundësuar aksesimin e lirë dhe pa pengesa të personave me aftësi ndryshe.

Me qëllim garantimin e fshehtësisë së votës, veçanërisht për votuesit e moshës së tretë dhe me aftësi të kufizuara, KQZ ka vlerësuar dhe ka

ridimensionuar materialet zgjedhore që lidhen me zbatimin në praktikë të këtij parimi.

6)

### **Përmirësimin e organizimit dhe të funksionimit të strukturës organike të KQZ, si dhe të performancës së kësaj strukture**

Me vendimin nr.74/2022, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e kuvendit nr. 67/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, është miratuar struktura dhe organigrama e re e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila numëron gjithsej 95 (nëntëdhjetë e pesë) pozicione pune.

Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, KQZ miratoi planin e saj të parë strategjik 5 vjeçar për periudhën 2022-2026.

Në kuadër të përmirësimit të aftësive menaxheriale të stafit të KQZ në bashkëpunim me organizma të ndryshëm ndërkombëtar janë zhvilluar programe të ndryshme trajnimi.

### **7) Përgatitjen për zgjedhjet vendore të vitit 2023;**

Ky aspekt i veprimtarisë së KQZ për vitin 2022 ka përfshirë më shumë periudhën e 6 mujorit të dytë të këtij viti.

U miratua plani i veprimit 2022 – 2023 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, si dhe “programi analitik i akteve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Në përgatitje të zgjedhjeve vendore të vitit 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar 41 (dyzet e një) vendime si dhe 2 (dy) udhëzime. Të gjitha aktet janë konsultuar paraprakisht me partitë politike dhe me shoqërinë civile.

## 8) Të ndryshme

### Dekriminalizimi

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka verifikuar, 36 (tridhjetë e gjashtë) kandidatë për anëtarë këshilli bashkiak, 3 (tre) kandidatë për deputetë jashtë periudhës zgjedhore, si dhe 20 (njëzet) kandidatë për kryetar bashkie për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022.

Përsa i përket **aspekteve të tjera të veprimtarisë** së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në 2022, sjellim në vëmendje angazhimin tonë në kuadër të mundësisimit të votimit nga jashtë, apo votës së diasporës sikurse në përditshëmri e referojmë këtë proces.

Këtu në Tiranë në Maj, u organizua një konferencë kombëtare e nivelit të lartë me temë “Votimi nga jashtë vendit, koha është tani”.

Kjo konferencë shërbeu si një platformë diskutimi midis përfaqësuesve të Kuvendit, të partive kryesore politike, të institucioneve shtetërore, të diasporës, të partnerëve ndërkombëtarë si dhe ekspertëve e aktorë të shoqërisë civile. Konferenca trajtoi çështje që lidhen me krijimin e kushteve dhe zbatimin e masave për mundësimin e votimit nga jashtë vendit në zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin.

Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 38, datë 09.12.2022 (V-38/22) vlerësoi se votimi nga jashtë nuk u zhvillua (dhe rrjedhimisht nuk mundet të zhvillohet) pasi ka boshllëqe rregullatore të këtij procesi në Kodin Zgjedhur. Gjykata Kushtetuese në këtë vendim ka urdhëruar plotësimin e këtyre boshllëqeve brenda një viti nga data e vendimit të saj, praktikisht brenda vitit 2023.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka shprehur Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore dhe Kuvendit gatishmërinë për të dhënë çdo kontribut që do të kërkohet nga ky Komision lidhur me çështje të natyrës rregullatore dhe teknike sa i takon realizimit të votimit nga jashtë.

KQZ fuqizoi strukturën e votimit nga jashtë për t'i paraprirë procesit të ardhshëm të zgjedhjeve parlamentare të parashikuara për t'u zhvilluar në vitin 2025.

Mundësimi i votimit nga jashtë vendit është prioritet i KQZ-së për zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin, por më së pari Kuvendi i Shqipërisë duhet të përmbushi urdhërimin e Gjykatës Kushtetuese brenda këtij viti, për plotësimin e boshllëqeve në Kodin Zgjedhor në lidhje me këtë votim. Përndryshe sikurse mundet të kuptohet votimi nga jashtë apo i diasporës sikurse i referohemi nuk do të realizohet as në vitin 2025.

Gjithashtu në vlerësimin tonë Komisioni e Reformës Zgjedhore e më pas Kuvendi i Shqipërisë është e udhës të adresojë për ndryshim edhe aspekte të tjera të Kodit Zgjedhor:

1. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisioneve të niveleve të dyta dhe të treta duhet të rikonsiderohet.

Do të ndryshonte rrënjësisht për mirë standarti i administrimit të procesit zgjedhor në këto nivele nëse të paktën një anëtar, ose sekretari i këtyre komisioneve të caktohej nga KQZ jo mbi bazë të propozimeve të partive politike.

Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e komisioneve të niveleve të dyta dhe të treta, përndryshe duhet qartësimi i formulës së barazpeshimit të administratës zgjedhore shumicë parlamentare dhe opozitë parlamentare (përbërja e KZAZ, KQV e GN).

2. Rregullat mbi financimin e fushatës zgjedhore dhe pasqyrimin e saj në lloje të ndryshme mediash përfshi edhe ato online, si dhe në rrjetet sociale duhet gjithashtu në vlerësimin tonë të rikonsiderohen;
3. Të përcaktohen rregullave për financimin nga dhe të ashtuquajtura palë të treta.
4. Rregullat mbi ankimet zgjedhore të tilla si mbi afatet, subjektin ankues, organin shqyrtues duhet të rikonsiderohen;
5. Sanksionet administrative për shkeljet në fushën e zgjedhjeve, për financimin dhe median duhen qartësuar.
6. Për shpërdorimin e burimeve publike, parashikuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor, duhen parashikuar sanksione konkrete në nenin 171.
7. Ndalimet për veprimtarinë e administratës në funksion të zgjedhjeve, duhen qartësuar për sa i përket llojit/kategorisë dhe periudhës së ndalimit.
8. Të ndryshohen dhe/ose të qartësohen rregullat e ngritjes së qendrave të posaçme të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.



9. Rritja e masës së sanksioneve për njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) në rast të mos përmbushjes së detyrave që u ngarkon Kodi Zgjedhor.
10. Të parashikohet sanksion i posaçëm ndaj bashkive që nuk bëjnë vlerësim objektiv të qendrave të votimit brenda afateve ligjore.
11. Të qartësohen kompetencat e institucioneve qendrore dhe vendore lidhur me garantimin e infrastrukturës në ambientet që përdoren si qendra votimi, për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.
12. Rishikim i afateve ligjore në lidhje me regjistrimin e subjekteve zgjedhore. Zgjatje e aftit kohor.  
Të uniformizohen dhe të unifikohen përgjegjësitë dhe rregullat për regjistrimin e subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.
13. Rishikim i afateve ligjore për verifikimin e dokumentacionit dhe pastërtisë së figurës të kandidatëve.
14. Sistemi i rekrutimit të operatorëve teknikë të përdorimit të teknologjisë së informacionit të lejoj përfshirjen të punonjësve publik, si rregull (kjo për të shmangur rastet e mos rekrutimit të operatoreve ose mos-paraqitjen në detyrë ditën e zgjedhjeve).
15. Miratimin i strukturës së përkohëshme të administratës së KQZ duke e lehtësuar këtë proces dhe bërë më fleksibël për KQZ. Angazhimi i vendimarrjes së Kuvendit në një proces kaq shumë teknik mendoj se nuk është me dobi;



KQZ



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



[www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)